



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

VENDIM

Nr. 01, datë 30.04.2025

PËR

PËRCAKTIMIN E SHTETEVE QË SIGUROJNË NJË NIVEL TË
MJAFTUESHËM TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Në mbështetje të pikave 2 dhe 3 të nenit 40, germës “gj”, pikës 1, të nenit 82, pikës 1 të nenit 85, dhe pikës 2 të nenit 97, të ligjit nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim quajtur “*Ligji*”), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V E N D O S I :

1. Shtetet që sigurojnë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, mbështeten në kriteret si më poshtë:
 - a) Shtetet anëtarë të Bashkimit Evropian, që zbatojnë Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (GDPR), e cila përbën një akt të përbashkët, drejtpërdrejtë të zbatueshëm, që përmban parimet thelbësore dhe rregullat e përpunimit të të dhënave personale;
 - b) Shtetet anëtarë të Zonës Ekonomike Evropiane, që në bazë të Marrëveshjes së EEA¹-së, zbatojnë Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR);
 - c) Palët e Konventës 108 të Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale” si dhe Protokollit të saj shtesë të vitit 1981, të cilat kanë miratuar një ligj për mbrojtjen e të dhënave dhe kanë krijuar një autoritet mbikëqyrës që ushtron funksionin e tij me pavarësi të plotë, duke siguruar mekanizma ligjorë të përshtatshëm, përfshirë trajtimin e ankesave, hetimin dhe garantimin e transparencës në përpunimin e të dhënave personale;
 - ç) Shtetet, ku transferimi i të dhënave personale, mund të kryhet sipas një vendimi përshtatshmërie të Komisionit të Bashkimit Evropian;
 - d) Me vendim të Komisionerit për shtetet ose organizatat ndërkombëtare që plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 40, pika 3, të Ligjit.

¹ European Economic Area (EEA) – Zona Ekonomike Evropiane

2. Shtetet që konsiderohen se garantojnë një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale sipas kritereve më sipër, janë të përcaktuar në Aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Vendimi nr. 8, datë 31.10.2016 *“Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”*, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

Aneks nr. 1

VENDET TË CILAT KANË NIVEL TË MJAFTUESHËM PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

- Andorra
- Argjentinë
- Austri
- Belgjikë
- Bosnjë dhe Hercegovinë
- Bullgari
- Danimarkë
- Estoni
- Finlandë
- Francë
- Greqi
- Guernsey
- Gjeorgji
- Gjermani
- Holandë
- Hungari
- Irlandë
- Islandë
- Ishulli i Manit
- Ishujt Faroe
- Itali
- Izrael
- Japoni
- Jersey
- Kanada²
- Korea Jugore
- Kosovë
- Kroaci
- Letoni
- Lihtenshtajn
- Lituani
- Luksemburg
- Mal i Zi
- Maltë
- Maqedoni e Veriut
- Mbretëri e Bashkuar
- Moldavi
- Monako
- Norvegji
- Poloni
- Portugali
- Qipro
- Republikë Çeke
- Rumani
- San Marino
- Serbi
- Sllovaki
- Slloveni
- Spanjë
- Suedi
- Shtetet e Bashkuara të Amerikës³
- Uruguaj
- Zelandë e Re
- Zvicër

² Niveli i mjaftueshëm zbatohet vetëm për shoqëritë tregtare sipas Vendimit të Komisionit Evropian 2002/2/EC, datë 20 dhjetor 2001.

³ Niveli i mjaftueshëm zbatohet vetëm për shoqëritë tregtare që aderjnë në Kuadrin për Mbrojtjen e të Dhënave BE - SHBA sipas vendimit të Komisionit Evropian 2023/1795, datë 10 korrik 2023.